



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 46 datë 29-05-2025

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, bazuar në dispozitat ligjore, në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 4, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB Nr.97 datë 27.07.2023 “ Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i qirasë në tregun e lirë, VKB Nr.165 datë 24.12.2024 “Mbi miratimin e vlerës mesatare të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë”, VKB Nr. 176, datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2025 dhe të PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 2(dy) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’i jepet përfituesve që nga data e miratimit të listës bashkëngjitur nga Këshilli Bashkiak.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-05-2025

KRYETAR

Ana VERUSHI



Tabela nr.1 e Vendimit
Lista familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë 2025

Nr	Emri / Atesia / Mbiemri	Kateg oria sipas nënit 16, të ligjit nr.22/ 2018	Përberja Familjare	Struktura e Apartamentit	Sipertage e Apartamentit	Qiraja mes. e apart. në treg për strukturen që i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas pikës 45, e nënit 2, të ligjit 22/2018)	Aftësia përballuese sipas nënit 3 të ligjit	Qiraja e përballueshme (h*)	Subvencioni në muaj (g-k)	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia (0.3*1)	Shuma që kërkohej nga buxheti (0.7*1)
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Olivera Thoma Simaku	B/1	3	1+1	54	12,000	15,000	Sh.të.ulta	15%	2,250	9,750	2,925	6,825
	Shuma Mujore/lekë												
	Shuma Vjetore/ lekë 7 muaj											20,475	47,775
													68,250


KRYETARI
Ana VERUSHI